

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 592 Prot.

Tiranë, më 03.062016

**VENDIM Nr. 53, datë 20.05.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin e verifikimit të terrenit në kuadër të gjetjeve rastësore përgjatë rrugës Apoloni-Kryegjatë*"- paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me ZAKPA Apoloni,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Relacionin e verifikimit të terrenit në kuadër të gjetjeve rastësore përgjatë rrugës Apoloni-Kryegjatë*"- paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me ZAKPA Apoloni.
2. Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit nga Parku Arkeologjik i Apolonisë, me qëllim dokumentimin e plotë të varrit të gjetur, nën dijeninë e ASHA.
3. Të kryhet nga ZAKPA konservimi dhe dokumentimi i gjetjeve (fragmenteve të enës së madhe të qeramikës dhe stelës dhe fragmentit të dyshemesë prej horasani).  
Depozitimi i fragmenteve të enës së madhe të qeramikës dhe stelës të bëhet në ambientet Parkut Arkeologjik të Apolonisë, ndërsa për stelën të kryhet edhe regjistrimi pranë QKIKP.
4. Të realizohet mbulimi i fragmentit të dyshemesë prej horasani, e cila duket në profilin e rrugës, me qëllim mosdëmtimin e mëtejshëm nga faktorë të ndryshëm.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETARI I KKA**  
**RUDINA ZOTO**